



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

Lënda: Mbi dërgimin e raportit të monitorimit të shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për 8-mujorin e vitit 2023.

Ministria e Mbrojtjes administron dhe menaxhon fondet publike, sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”;
- 2) Programi “Forcat e Luftimit”;
- 3) Programi “Mbështetja e Luftimit”;
- 4) Programi “Arsimimi Ushtarak”;
- 5) Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”;
- 6) Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”;
- 7) Programi “Emergjencat Civile”.

• **KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS**

Për 8-mujorin e vitit 2023, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin me ndryshime të kësaj periudhe, (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet dhe me financim të huaj) paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi i programit	Realizimi në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	86%
2.	Forcat e Luftimit	78%
3.	Mbështetja e Luftimit	69%
4.	Arsimimi Ushtarak	57%
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	64%
6.	Mbështetje për Ushtarakët	90%
7.	Emergjencat Civile	21%
Totali i Ministrisë		70%

Nga një vështrim i përgjithshëm, duke gjykuar vetëm mbi realizimin në vlerë të shpenzimeve të planifikuara për 8 -mujorin e vitit 2023, **niveli i realizimit është 70 %.**

Niveli prej 70 % është relativisht pozitiv për Ministrinë e Mbrojtjes, duke konsideruar faktin që jemi në 4-mujorin e dytë të vitit dhe procedurat janë në proces prokurimi, si dhe shpenzimet e personelit për shkak të mosplotësimit të strukturave organike të disa njësive shpenzuese. Arsye tjetër është niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve kapitale pasi fondet nuk janë kontraktuar.

Ndërsa sipas zërave të shpenzimeve buxhetore **vetëm me financim të brendshëm**, duke përjashtuar *investimet dhe me financim të huaj*, **niveli i realizimit është 46 %** dhe situata për çdo program për 8-mujorin e vitit 2023 paraqitet e tillë:

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente 8 -mujori i vitit 2023 (në %)	Shpenzime kapitale të brendshme 8-mujori i vitit 2023 (në %)	Totali i shpenzimeve buxhetore 8-mujori i vitit 2023 (në %)
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	88	34	86
2.	Forca e Luftimit	84	72	78
3.	Mbështetja e Luftimit	79	28	69
4.	Arsimi Ushtarak	81	0	57
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	80	23	64
6.	Mbështetje Sociale për Ushtarakët	90	0	90
7.	Emergjencat Civile	33	9	21
Totali i Ministrisë		80	46	70

Për të gjitha programet në nivel ministrie realizimi i shpenzimeve korrente paraqitet me 70 %, duke variuar nga më i ulëti Programi “Emergjencat Civile” me 21 %, “Programi Mbështetja e Luftimit” me 48%, Programi Mbështetje për Shëndetësinë “me 55%, Programi Arsimi Ushtarak “me 57%, Programi “Forca e Luftimit” me 78 %, Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” me 86 %, deri te dy programet me realizim më të lartë “Mbështetje Sociale për Ushtarakët” me 90%. Në mosrealizimin në nivelin e planifikimit të shpenzimeve operative ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga për mosplotësim të strukturave të miratuara në të gjithë programet, mosrealizimi në shpenzimet për mallra dhe shërbime si rrjedhojë e procedurave të prokurimit, i programit “Emergjencat Civile”.

Ndërsa në zërin e **shpenzimeve kapitale të brendshme, Ministria paraqitet me realizim prej 46%.**


Duke iu referuar Aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit, ndër 7 programet e Ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2023:

Tabela nr.3

Emërtimi i programit	Struktura e shpenz. sipas buxhetit fillestar 8-mujori i vitit 2023 në %	Struktura e shpenz. sipas buxhetit me ndryshime 8-mujori i vitit 2023 në %	Struktura e shpenz. sipas faktit 8-mujori i vitit 2023 në %
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	88	34	86
Forcat e Luftimit	84	72	78
Mbështetja e Luftimit	79	28	69
Arsimimi Ushtarak	81	0	57
Mbështetje për Shëndetësinë	80	23	64
Mbështetje për Ushtarakët	90	0	90
Emergjencat Civile	33	9	21
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	100	100	100

Grafiku Nr.1

Struktura e shpenzimeve faktike për Ministrinë Mbrojtjes, sipas programeve për 8-mujorin e vitit 2023



Rreth 37 % të totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë këtij 8-mujori, e ka programi “Forcat e Luftimit”, ndjekur nga shpenzimet për programet “Mbështetja e Luftimit” me 23 %, “Mbështetje për Ushtarakët” me 22%, “Mbështetje për Shëndetësinë” me 6%, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” me 5 %, “Arsimi Ushtarak” me 3 % dhe “Emergjencat Civile” me 3 %.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve në parashikimet sipas **buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, nuk ka ndryshime në asnjë prej programeve buxhetore** (e shprehur në % të përafërt ndryshimet janë të pakonsiderueshme).

Duke krahasuar strukturën e programeve sipas realizimit faktik gjatë periudhës dhe buxhetit me ndryshime konstatohet se në pesë programe ka rritje dhe në një program ka ulje.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes paraqitet me ulje në vlerën 239,150, mijë lekë për 8-mujorin e vitit 2023, sipas çdo programi, konkretisht ndryshimet paraqiten:

“Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”, Buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 2,567 mijë lekë.

“Forca e Luftimit”, Buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka ulje me 260,868 mijë lekë.

Mbështetja e Luftimit, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 15,454 mijë lekë.

“Arsimi Ushtarak”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 2,139 mijë lekë.

“Mbështetje për Shëndetësinë”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 1,054 mijë lekë.

“Emergjencat Civile”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 504 mijë lekë.

Niveli i realizimit në vlerë sipas strukturës së tyre në buxhetin e ministrisë për 8-mujorin e vitit 2023 paraqitet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr. 4

në 000/lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti me ndryshime 8-mujor (limiti)	Struktura në %	Fakti 8-mujor i vitit 2023		
				në 000/lekë	Realizimi në %	Struktura në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,606,291	4	855,062	53	5
2.	Forcat e Luftimit	17,999,632	45	5,747,287	32	37
3.	Mbështetja e Luftimit	7,675,113	19	3,650,667	48	23
4.	Arsimimi Ushtarak	1,365,559	3	468,133	34	3
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,609,590	4	880,086	55	6
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	13	3,500,000	67	22
7.	Emergjencat Civile	4,560,804	11	506,217	11	3
Totali		40,016,989	100	15,607,452	39	100

PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE SIPAS PROGRAMEVE:

Tabela nr. 5

Programet Buxhetore	Buxheti fillestar 8-mujor, 2023			Buxheti me ndryshime 8-mujor, 2023		Diferenca buxheti me ndryshime, me buxhetin fillestar	
	Produkte	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	8	493	1,596,161	493	1,598,728	4	855,062
Forcat e Luftimit	27	28248	17,003,065	28248	17,941,132	11	5,747,287
Mbështetja e Luftimit	50	87612	87,612	87612	7,613,379	29	3,650,667
Arsimimi Ushtarak	7	14,907	1,363,420	15,039	1,132,494	2	468,133
Mbështetje për Shëndetësinë	4	103,338	1,608,536	89,416	1,609,590	1	880,086
Mbështetje për Ushtarakët	5	29,324	5,200,000	29,324	5,200,000	5	3,500,000
Emergjencat Civile	18	99,036	2,796,800	99,036	2,797,304	9	506,217
Shuma Totale	119	362,958	29,655,593	349,168	37,892,626	61	15,607,452

Për informacion më të detajuar mbi sasitë e produkteve të realizuara, lutemi referojuni aneksit bashkëlidhur.

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”.

Në bazë të informacioneve të paraqitura drejtuesit e njësive shpenzuese, ku fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.7 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për 8-mujorin 2023. Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike.

Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesore janë:

1. Sigurimi i menaxhimit eficient dhe efektiv të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Modernizimi i infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Funkcionimi eficient i sigurt, si dhe modernizim i mëtejshëm i infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, **nëpërmjet 3 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 5 Projekte Investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”**. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 2,567 mijë lekë.

Ndryshimi i planit të produkteve në total për këtë periudhë është rritur në vlerën 2,567 mijë lekë, që i përket shtesës së fondeve nga fondi i veçantë për ndihma të ndryshme ekonomike në një 1 produkt të planifikuar në art.606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”.

Për 8-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar **8 produkte** me vlerë 999.383 mijë lekë dhe janë realizuar **4 produkte** me vlerë 854.540 mijë lekë ose 86%.

Realizimi në këtë nivel ka ardhur si rezultat i menaxhimit efektiv të fondeve. Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6

në 000/lekë

Produktet	Buxheti 8-mujor i vitit 2023	Realizimi 8-mujor i vitit 2023	
	në (000/lekë)	Në (000/lekë)	Në %
Akte ligjore e nënligjore të përgatitura.	645,767	634,309	98
Marrëveshje të realizuara.	183,616	87,291	47
Sisteme të mirëmbajtura.	120,000	116,367	97
Përmirësimi në hardware, softwre dhe ndërtim i dhomave të serverëve (NJUSK).	20,000	17,095	85
Krijimi i Qendrës së Inovacionit për cyber security.	10,000	-	-
Blerje pajisje Tik për MM-në dhe FA-në.	10,000	-	-
Sistem zjarifikës për dhomat e serverëve.	5,000	-	-
Përmirësimi i Sistemit Financiar për MM-në.	5,000	-	-
Totali	999,383	855,062	86

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin e vitit 2023 në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente	88%
Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale	34%
Gjithsej	86 %

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 855,084 mijë lekë ose 86%.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Programi “**Forcat e Luftimit**” përmban 3 nënprograme: **Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare dhe Komanda e Forcës Ajrore**. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike.

Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesore janë

- Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Tokësore;

- Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Detare;
- Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Ajrore.

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 35 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për periudhën raportuese dhe shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 4 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 35 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është ulur në vlerën 260,868 mijë lekë.

- Shtesë në shpenzime operative në vlerën 9132 mijë lekë;
- Pakësim në shpenzime kapitale në vlerën 270,000.

Për 8-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar 40 produkte me vlerë 7,340,117 mijë lekë dhe janë realizuar 11 produkte me vlerë 5,747,287 mijë lekë ose 78%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative janë realizuar 4 produkte me vlerë 3,374,352 mijë lekë ose 84%;
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 7 projekte me vlerë 2.372.935 mijë lekë ose 72%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 5,747,287 mijë lekë ose 78%.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Forcat e Luftimit” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7

në 000/lekë

Kodi i produktit	Produktet	Buxheti 8-mujor në (000/leke)	Realizimi 8-mujor, viti 2023	
			Realizimi 8-mujor në (000/lekë)	Në %
91702AA	Forca Tokësore në gatishmëri dhe operacionale.	1,768,057	1,724,646	97.5
91702AB	Kontingjent ushtarak në mision paqeruajtëse jashtë vendit.	470,000	460,960	98.1
M170424	Armatim i lehtë, municione dhe aksesore, makineri e pajisje.	2,400,717	1,931,994	80.5
18 AY915	Rikonstruksion i rrjetit të komunikimit me fibër optike.	4,000	0	0.0
18 AY916	Pajisje të sallave operacionale, ndërtesave të reja me orendi, sisteme IT-je.	36,145	36,009	99.6
18AY909	Ndërtim objektesh dhe punime për rikonstruksione të godinave të KFT-së, Zall-Herr.	350,000	279,864	80.0
18AY918	Ndërtim i rrjetit inxhinierik i Poligonit Kombëtar Pajet.	0	0	#DIV/0!

18AY919	Ngritja e sistemit të sigurisë dhe i rrethimit të Poligonit Kombëtar Pajet.	0	0	#DIV/0!
M170203	Ndërtim godine për strehim ushtarakësh.	0	0	#DIV/0!
91702AC	Forca Detare në gatishmëri dhe operacionale	895,998	608,745	67.9
18AZ025	Predha për topin automatik 20 mm (102 HEI) të anijeve të klasit “ILIRIA”.	72,300	0	0.0
18AZ007	Rikonstruksioni për instalimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në flotiljen detare Pashaliman (Prona nr.937).	12,000	0	0.0
18 AZ018	Sistem i komunikimit të anijeve anije-tokë-anije.	0	0	#DIV/0!
18AZ019	Pajisje elektronike për grupin e bordingut	0	0	#DIV/0!
18AZ021	Rikonstruksion i dhomës së re të serverëve të SIVHD (Serverët do të transferohen në dhomë tjetër të përshtatshme) Prona nr. 245.	4,500	0	0.0
18AZ022	Ndërtim i sistemit të rrjetit elektrik Maja e Thanasit, Llogara, prona nr. 1273.	12,000	0	0.0
M170533	Rimovimi dhe përmirësimi teknologjik i sistemeve të SIVHD.	45,000	0	0.0
18 AZ028	Ndërtim godine për PSV, Maja e Thanasit, prona nr.1273.	20,000	0	0.0
18 AZ029	Rrethim i vendbazeve Shëngjin dhe sistem sigurie me kamera (prona nr. 974).	0	0	#DIV/0!
18 AZ030	Ndërtim i sistemit autonom panele diellore (PRT dhe Vendbazimi Sazan, prona nr. 915).	15,000	0	0.0
18 AZ031	Përmirësimi i sistemit të ujerave të zeza dhe ndërtimi i gropës septike, Flotilja Detare.	10,000	0	0.0
18 AZ032	Ndërtim i depos së armatimit Pashaliman.	20,000	0	0.0
18 AZ033	Rikonstruksion i rrjetit të sistemit të ujit të pijshëm Pashaliman.	20,000	0	0.0
M170231	Kompresor (300 bar) dhe gjenerator për QZH për operacionet VSWMCM.	0	0	#DIV/0!
M170203	Fond i ngrirë.			
91702AE	Forca Ajrore në gatishmëri dhe operacionale	889,400	580,001	65.2
18AZ107	Fonde Kombëtare për ASBE-ACCS Besad Element.	0	0	#DIV/0!
18AZ209	Sisteme dhe pajisje për operacionet e kërkim-shpëtimit SAR dhe EC.	3,000		0.0
18AZ213	Vegla dhe pajisje për shërbimin dhe riparim/mirëmbajtjes për nivelin II të helikopterëve.	0		#DIV/0!
21AC101	Avion pa pilot të armatosur, Dron	0		#DIV/0!
M170327	Hangarë për helikopterët Blackhawk.	99,200	0	0.0

18AZ219	Fonde Kombëtare për ASBE (punime civile) Rinas.	0	0	#DIV/0!
18AZ106	Ndërtim i perimetrit të sigurisë në Bazën Ajrore Kuçovë.	94,500	94,500	100.0
18AZ220	Punime infrastrukturore Baza Ajrore Kuçovë.	70,000	10,767	15.4
M170203	Fond i ngrirë.			
M170508	Sistemi i komunikimit Tokë-Ajër-/G-A-G.	15,800	14,879	94.2
18AZ217	Shpronësime tokash Kuçovë.	5,000	4,922	98.4
18AZ221	Hangarë mjedise për mirëmbajtjen e riparimit dhe të testimit.	0	0	0
18AZ222	Depo për ruajtjen e materialeve të avionëve pa pilot.	7,500		0
21AC108	Rikonstruksion i Shtëpisë së Ushtrakeve Kuçovë.	0		0
	Totali	7,340,117	5,747,287	0

Gjatë periudhës 8-mujore, volumi i buxhetit ka ndryshuar si më poshtë:

- Shtesë në artikullin 606 “Transferta familjare” në vlerën 1.204.mijë lekë, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5434/1, datë 31.03.2023 “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2023”.
- Pakësuar në artikullin 231 “Investime”, vlera 270,000 mijë lekë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.12140/1, datë 07.07.2023.

3.Programi “Mbështetja e Luftimit”

Programi “Mbështetja e Luftimit” përmban 13 nënprograme: Komanda Mbështetëse, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtrake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes Muzeu i FA-së, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencia e Sistemit të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Batalioni i Mbështetjes, Policia Ushtrake e Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

Për vitin 2023 disa nga objektivat kryesore janë:

- Objektivi 1: Sigurimi i logjistikës së nevojshme, si dhe mbështetja në operacione humanitare e misione ndërkombëtare.
- Objektivi 2: Sigurimi i inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet.
- Objektivi 3: Sigurimi dhe mbështetja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s.
- Objektivi 4: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak dhe civil.

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 22 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për periudhën dhe shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 13 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 59 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 15,454 mijë lekë në shpenzime operative.

Për 8-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar 72 produkte me vlerë 5,328,575 mijë lekë dhe janë realizuar 11 produkte me vlerë 3,650,607 mijë lekë ose 69 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative janë realizuar 4 produkte me vlerë 3,352,024 mijë lekë ose 79%;
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 7 projekte me vlerë 298,583 mijë lekë ose 28%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 3,650,607mijë lekë ose 69%.

Realizimi i projekteve të investimeve për këtë program për 8-mujorin e vitit 2023 arrin në masën 28 % Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Tabela nr. 8

në 000/lekë

Nr.	Kodi i produktit	Produktet	Buxheti 8-mujor në (000/lekë)	Realizimi 8-mujor, viti 2023	
				Realizimi 8-mujor në (000/lekë)	Në %
1.	91703AA	Kapacitete operacionale që sigurojnë mbështetje logjistike të FARSH-it.	2,226,890	1,470,403	66
2.	18CI201	Ndërtim i Muzeut të Forcave të Armatosura.	126,255	60,944	48
3.	M170237	Blerje, studime, përgatitja e projekteve dhe preventivave.	10,000	10,000	100
4.	M170411	TVSH për projektet e KM-së.	8,034	86	1
5.	18AZ405	Ndërtim grup-depo për pajisjet e kërkim-shpëtimit.	58,975	53,556	91
6.	18AZ406	Rikonstruksioni i rrethimit të jashtëm/VR dhe portës hyrëse në Repartin Ushtarak nr. 4030.	12,495	4,868	39
7.	18AZ310	Ndërtim sistem sigurie në Garnizonin Vaqar, grup-depo Shkozë, depo karburanti Linzë.	17,901	17,901	100
8.	18AZ410	Rikonstruksion i rrethimit të jashtëm/VR dhe postbllokut të DMR Korçë.	22,374	18,564	83
9.	18CI301	Dizenjimi i uniformave të FA-së.	7,229	7,229	100
10.	18AZ412	Rikonstruksion ambientesh, blerje aparaturash mjekësore e dentare dhe pajisje orendi.	42,534	7,043	17
11.	18AZ415	Rikonstruksion tërësor i ndërtesës së komandës dhe shtabit të batalionit (Rep. nr. 4007), dëmtuar nga tërmeti, rrethimi, sistemi i sigurisë, ndërtim depo karburanti, rikonstruksion ofiçine, rikonstruksion parqesh, prona nr.149 Pezë - Helmes, 50-30 mil.	4,459		0

12.	18AZ416	Rikonstruksion ndërtesash, rrethim pjesor, ndërtim sistem sigurie Rep. nr. 4009, prona nr.176 Ferraj, Tiranë.	20,737		0
13.	18AZ417	Rikonstruksion ndërtesë dykatëshe, ndërtim parku për mjete speciale, rikonstruksion rruge dhe sheshe për Rep nr.4030, prona nr. 86, 87 Ferraj, 40-30-35 mil.	10,000		0
14.	18AZ419	Rikonstruksion deposh, godina 1 katëshe, truproje, rrethim pjesor, sistem sigurie pjesore grup-depo Mengel, prona nr.318,319 Mengel	21,000		0
15.	18AZ420	Rikonstruksion truproje, rrethim pjesor, sistem sigurie pjesor, prona nr.122 Marikaj, Vorë	24,000		0
16.	18AZ421	Rikonstruksion truproje porta hyrëse rrethim pjesor sistem sigurie grup-depo Shkozë, Durrës, prona nr.215.	12,000		0
17.	91703AI	Inteligjenca Ushtarake për autoritet e drejtimit dhe komandimit të FA-së	238,033	213,596	90
18.	18AZ307	Pajisje dhe softë për përmirësimin e sistemit në AISM.	10,000	0	0
19.	18AZ312	Zhvillimi i kapaciteteve O1001; K1002; S1003; S1004; L1005; N1006; N1007; R1008; I1009; M1010; M1011.	131,000	0	0
20.	18AZ327	Zhvillimi i kapaciteteve T1012; B1013; R1014; R1015; I1016; N1017.	10,000	0	0
21.	91703AC	Qendra e Kulturës Funktionale.	99,850	75,973	76
22.	18AZ331	Blerje pajisje TIK për sektorin e Medias	360		0
23.	M170340	Rikonstruksion objekti ESKU dhe mbikëqyrje punimesh “EPIDAMNOS”, detyrim i pafinancuar e i palikuiduar që nga viti 2013.	215	215	100
24.	91703AE	Personel i rekrutuar dhe dosje të administruara për trajtim financiar.	282,500	234,107	83
25.	18AZ413	Përshtatje dhe rikonstruksion ambientesh për zyrat e rekrutimit në rrethe.	26,000	5,216	0
26.	18AZ322	Kompletim i ambienteve për zyrat e rekrutimit në rrethe.	15,000	6,379	0
27.	91703AL	Sisteme funksionale kontrolli për FA-në.	261,048	216,174	0
28.	18AZ308	Projekt për mbështetje me burime ushqimi elektrik BUE.	20,000	14,745	74
29.	18AZ501	Blerje pajisje hardware për rrjetet e paklasifikuara në FA.	22,000	0	0
30.	18AZ502	Ndërtimin e sistemit të Telefonisë VoIP & VTC në FA (radirole digitale)+ FD.	20,000		0
31.	18AZ505	Licenca dhe programe softëurike për FA.	30,000		0
32.	18AZ506	Pajisje hardware për rrjetin e klasifikuar në FA.	30,000		0
33.	18AZ517	Sistemi i radiokomunikimit digjital në FA.	15,000		0
34.	18AZ511	Pajisje hardware për Sistemin e Menaxhimit të Ngjarjeve dhe të Sigurisë së Informacionit (SIEM).	20,000		0
35.	18AZ512	Licenca programe për SIEM.	19,380		
36.	18AZ513	Rrjeti Kombëtar i Klasifikuar NATO Sekret.	16,720		
37.	91703AJ	Hapësirës detare të monitoruar.	27,024	20,270	
38.	18AZ411	Rikonstruksion i godinës QNOD.	10,058		
39.	18AZ328	Kondicioner zyresh 9-btu.	700		
40.	18AZ329	Kondicioner Dollap SO (30-40) BTU.	700		
41.	18AZ330	Printer Fotokopje Rrjeti i Përqendruar.	600		
42.	91703AF	Sistem i Automatizuar Logjistik i Menaxhuar	69,670	54,064	

43.	18AZ314	Pajisje për Laboratorin Qendror të FA-së	2,920		
44.	18AZ323	Modernizimi i pajisjeve dhe aparaturave për monitorimin e mjedisit, analizimin e CBRN.	5,080		
45.	18AZ422	Rikonstruksion i magazinave të kimikateve dhe materialeve të kazermimit në depo. Aspirimi i tyre.	2,000		
46.	91703AK	Polici Ushtarake funksionale.	415,811	391,656	
47.	91703AM	Objekte në ruajtje dhe godina pushimi të ofruara.	538,670	480,743	
48.	18CI403	Sistemim i infrastruktures se jashtme, rruga IGJIU-AISM-QPR në garnizonin Skënderbej	4,000		
49.	18CI405	Rikonstruksion i godinave të dëmtuara nga tërmeti prona 231, në SHPU Durrës, godina nr.4 dhe 8.	9,000		
50.	18CI406	Rikonstruksion i godinave SHPU Jalë (Nyje Sanitare dhe hidroizolim tarrace).	3,000		
51.	18CI408	Pajisje hotelerie për SHPU Jalë, Durrës, Pogradec dhe Vlorë.	9,142	5,951	
52.	18CI409	Sistemim i infrastrukturës + Postblloku nr.4 + Drenazhim i fushës së futbollit në Garnizonin “Skënderbej”.	50,000		
53.	18CI410	Rikonstruksion i dy objekteve tip tunel në pronën nr.206, Bërzhitë, Tiranë.	5,000		
54.	91703AD	Arkiva funksionale.	22,350	18,138	
55.	18AZ319	Sistemi i digjiitalizimit të dokumenteve arkivore	39,000		
56.	91703AG	Licenca import/eksport të dhëna.	25,312	19,975	
57.	91703AH	Harta ushtarake të prodhuara.	53,269	39,771	
58.	18AZ313	Ngritja e sistemit të informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturën ushtarake në shërbim të IGJIU-së	77,000	77,000	
59.	M170237	Blerje, studime, përgatitja e projekteve dhe preventivave.	30,000	8,886	
60.	18AZ423	Përshtatja e ambienteve të reja në garnizonin “Skënderbej” për magazinimin e produkteve hartografike, sistemimi i arkivit.	10,000	0	
61.	18AZ324	Abonimi dhe suporti teknik vjetor për setin e programeve “Teledzne Cartis”, për realizim të hartave detare elektronike.	8,223	0	
62.	18AZ325	Abonimi dhe suporti teknik vjetor për programin “Sevens”, për realizimin e kontrollit të saktësisë së hartave detare elektronike ENC.	600	0	
63.	18AZ326	Programe të licencuara për sektorët e IGJIU-së.	17,457	0	
64.	91703AN	Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë.	174,166	117,154	
Totali			5,502,741	3,650,667	66

Ndryshimet në volumnin e buxhetit.

Shtesë:

Në artikullin 600 në vlerën 240,550 mijë lekë, sipas shkresës së sekretarit të përgjithshëm nr.3227/2, datë 22.06.2023 dhe shkresës nr.4420/2, datë 08.09.2023 për programin “Mbështetja e Luftimit”.

Në artikullin 601 në vlerën 84,800 mijë lekë.

Në artikullin 606 të fondit të veçantë, sipas shkresës së sekretarit të përgjithshëm nr. 3657/1, datë 03.07.2023 në vlerën 11,218 mijë lekë.

Pakësim:

Në artikullin 602 në vlerën 307,500 mijë lekë.

Në artikullin 606 në vlerën 17,734 mijë lekë.

Gjatë procesit të hedhjes së të dhënave të treguesve të performancës për 8-mujorin e vitit 2023 në sistemin AFMIS për Programin “Mbështetja e Luftimit” evidentohet problematika e mos shfaqjes në sistemin AFMIS të katër projekteve, si më poshtë:

1. “Blerje, studime, përgatitja e projekteve dhe preventivave”, me kodin **M170237**, në sistemin SIFQ, nga kapitulli 01 për Komandën Mbështetëse.
2. “Blerje, studime, përgatitja e projekteve dhe preventivave”, me kodin **M170237**, në sistemin SIFQ, nga kapitulli 01 për IGJIU-në.
3. “TVSH për projektet e KM”, me kodin **M170411**, në sistemin SIFQ, nga kapitulli 04 për Komandën Mbështetëse.
4. “Rikonstrukcion objekti ESKU”, me kodin **M170340**, në sistemin SIFQ, nga kapitulli 01 për Repartin Ushtarak nr.6004.

Projekti me kod **18AZ332** “Blerje Droni”, në sistemin AFMIS shfaqet me vlerë zero.

Për këto arsye treguesit e performancës për këto projekte nuk janë hedhur në sistemin AFMIS dhe është kërkuar ndërhyrja e MFE-së.

4. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.2 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për periudhën raportuese. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë” ka parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për vitin 2023 objektivat kryesore janë:

- Objektivi 1: Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT-së
- Objektivi 2: Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacientëve të afuara nga specialitetet mjekësore pranë SUT-së

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 4 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 1,054 mijë lekë në shpenzime operative në art 606 “Transerta për Buxhete Familjare dhe Individë”.

Për 8-mujorin e vitit 2023, janë parashikuar 4 produkte me vlerë **1,376,595 mijë** lekë dhe janë realizuar 4 produkte me vlerë 380,700 mijë lekë ose 64%.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Mbështetje për Shëndetësinë” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9

në 000/lekë

Emri i treguesit të performancës/produktit	Shpenzimet sipas planit të rishikuar të 8-mujorit, viti korrent	Shpenzimet Faktike në fund 8-mujorit, viti korrent	% e realizimit
Infrastrukturë shëndetësore, logjistike funksionale për trajtimin e pacientëve ambulatorë dhe të shtruar për shërbimin e urgjencës pranë SUT /91704AA.	995894.72	793562.503	80
Rikonstruksion godinash. Kodi I8AZ813.	304933.6	54086.458	18
Blerje mobilie. Kodi 18AZ814.	15766.4	15764.82	100
Blerje pajisje dhe aparatura mjekësore. Kodi 18AZ817.	60000	16672.2	28
Totali	1,376,595	880,086	

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative është realizuar 1 produkt me vlerë 793,563 mijë lekë ose 80%.
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 4 projekte me vlerë 86,523 mijë lekë ose 23%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 880,086 mijë lekë ose 64%.

5. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Programi “Arsimimi Ushtarak” synon rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Për vitin 2023 objektivat kryesore janë:

Arsimimi në të tre ciklet e studimit dhe kualifikimin në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit dhe komandimit të FARSH-it dhe institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

- Kualifikimi dhe përgatitja, menaxhimi, zhvillimi dhe vlerësimi i stërvitjes individuale bazë me rekrutët kandidatë për ushtarë/detarë aktivë dhe stërvitjes individuale të avancuar në bashkëpunim me strukturat e FA-së.
- Përgatitja e personelit ushtarak dhe civil në FA, në përputhje me detyrat që burojnë nga misionet kushtetuese të strukturave të Forcave të Armatosura në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe sigurisë kombëtare, si dhe për pjesëmarrjen në operacionet e emergjencave civile.

- Modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për arsimim, trajnim, stërvitje dhe kualifikim në të gjitha strukturat e AFA-së, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Bashkërendimi i veprimtarinë së AFA-së me MASR-në dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të programeve akademike.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 3 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 1,054 mijë lekë në shpenzime operative, në art 606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”.

Për 8-mujorin e vitit 2023 janë realizuar 7 produkte me vlerë 468,133 mijë lekë ose 57%.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të programit buxhetor “Arsimimi Ushtarak” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 10

në 000/lekë

Kodi i produktit	Produktet	Buxheti 8-mujor në (000/leke)	Realizimi 8-mujor, viti 2023	
			Realizimi 8-mujor në (000/lekë)	Në %
91705AA	Kapacitete të afta për trajnimin dhe arsimimin cilësor në Forcat e Armatosura.	643,500	468,125	73%
19AC403	“Ndërtim i godinës së re shumëfunktionale të AFA (Prona 21)”.	229,258	0	0
21AC001	Rikonstruktion Objekti nr. 8.	9	8	100%
19AC405	Rikonstruktion i rrjetit LAN të QS	0	0	0
19AC406	Blerje 35 licenca VBS3 dhe 15 laptopë për VBS3(MTT).	0	0	0
19AC407	Zëvendësimi i pajisjeve elektronike KDS (kompjuter, printer, fotokopje, projektor).	0	0	0
19AC408	Blerje pajisje kompjuterike (48 work station CPU, 2 serverë pajisje të tjera).	0	0	0
Totali		229,267	468,133	57

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8- mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative në vlerë **468,125** mijë lekë ose 81%.
- Në shpenzime kapitale në vlerë **8** mijë lekë ose 0%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 468,133 mijë lekë ose 57%

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Arsimimi Ushtarak” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar, produktet me kostot përkatëse që kontribuojnë në realizimin e tyre. Për këtë program kemi arritje të planit të produkteve nga produkti të planifikuar.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në 57 % ndaj buxhetit me ndryshime të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 5 produkteve. Për këtë program vërejmë se nuk ka ndryshim të planit të produkteve.

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 13.6 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për periudhën raportuese. Programi “**Mbështetje Sociale për Ushtarakët**” ka parashikuar objektiva specifike.

Për vitin 2023 objektivat kryesore janë:

- Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare.
- Trajtim të veçantë të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim.
- Transferta të brendshme për përballimin e pensioneve të parakohshme të ushtarakëve.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të Programit buxhetor “Arsimimi Ushtarak” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 11

në 000/ lekë

Produktet	Buxheti 8-mujor i rishikuar, viti 2023	Realizimi 8-mujor i vitit 2023	
		Në 000/lekë	Në %
Sigurimin suplementar të ish-ushtarakëve dhe ish-policëve.	1,648,833	1,568,833	95
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të pilotëve fluturues në pension.	146,640	66,640	45
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë i punonjësve të industrisë ushtarake.	130,740	50,740	39
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension.	88,527	8,527	10
Kontributet e buxhetit të shtetit në bazë të legjislacionit për financimin e ushtarakëve në pension të parakohshëm.	1,885,260	1,805,260	96
Totali	3,900,000	3,500,000	90%

Për 8-mujorin e vitit 2023 janë parashikuar **5 produkte** me vlerë **3,900,000 mijë** lekë dhe janë realizuar **5 produkte** me vlerë **3,500,000 mijë** lekë ose 90%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikullit 604, për vitin 2023, në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente 90%.

7. Programi “Emergjenca Civile”.

Programi i **Emergjenca Civile** përmban 2 nënprograme: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për vitin 2023 objektivat kryesore janë:

Objektivi 1: Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

Objektivi 2: Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore.

Fondet e miratuara për vitin 2023 për këtë program përbëjnë 11.4% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 5 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 10 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është ulur në vlerën 260,868 mijë lekë.

Për 8-mujorin e vitit 2023, janë parashikuar 15 produkte me vlerë **2,391,004 mijë** lekë dhe janë realizuar 9 produkte me vlerë **506,212 mijë** lekë ose 21.2 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative janë realizuar 5 produkte me vlerë **406,273** mijë lekë ose 32.7%.
- Në shpenzime kapitale janë realizuar 10 projekte me vlerë **99,939** mijë lekë ose 8.7%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 506,212 mijë lekë ose 21.2%.

Nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime dhe në mënyrë analitike realizimi i produkteve të Programit buxhetor “Emergjenca Civile” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12

në 000/lekë

Nr.	Kodi i produktit	Produktet	Buxheti 8-mujor në (000/leke)	Realizimi 8-mujor, viti 2023	
				Realizimi 8-mujor në (000/lekë)	Në %
1.	91707AA	Mbrojtja e jetës njerëzore, pronës, trashëgimisë kulturore dhe pyetje ndaj zjarrit.	362,614	218,847	60%
2.	91707AB	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.	314,950	100,296	32%
3.	91707AG	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme, për	485,050	26,897	6%

		mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve.			
4	18AZ901	Masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese në disa bashki të vendit.	988,000	65,216	7%
5	M170411	Bashkëfinancim, TVSH dhe taksa doganore.	10,000	6,119	61%
6	20AD102	Blerje software për përmirësimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm.	61,800	0	0%
7	20AD103	Aplikimi I sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe Web GIS.	18,000	0	0%
8	20AD104	Blerje software baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë.	8,300	0	0%
9	20AD105	Blerje sistem për video konferenca.	1,200	0	0%
10	22AG101	Bashkëfinancim me projektet e huaja.	20,000	19,589	98%
11	91707AD	Stoku i mallrave ushqimore (rezervë materiale shtetërore).	20,310	8,811	43%
12	91707AE	Stoku i mallrave industriale (rezervë materiale shtetërore).	60,780	51,422	85%
13	M170521	Blerje mallra rezervë shteti ushqimore.	24,000	9,015	38%
14	M170528	Blerje mallra rezervë shteti industrial.	14,000	0	0%
15	21AD301	Blerje ushqim për bagëti.	2,000	0	0%
		Totali	2,391,004	506,212	21%
		Investimet e huaja për AKMC	1,900,000	0	0%

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në 21.2% ndaj buxhetit me ndryshime për vitin 2023.

Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 84/2022 “Për buxhetin 2023”, evidentohet ndryshimi (pakësimi) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj”, pasi këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit.

Për informacion më të detajuar mbi sasitë e produkteve të realizuara, lutemi referojuni aneksit bashkëlidhur.

2. KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE NDËRMJET MINISTRISË DHE THESARIT

Nga të dhënat faktike (financim i brendshëm + huaj) të pesë programeve të Ministrisë së Mbrojtjes me situacionet raportuese të thesarit për periudhën 8-mujore të vitit 2023 paraqiten:

Tabela nr.13

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali shpenzimeve		
		Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesar	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
	Planifikim Menaxhimi	837,989	837,989	-	17,095	17,095	-	855,084	855,084	0
	Forca e Luftimit	3,374,352	3,374,352	-	2,372,935	2,372,935	-	5,747,287	5,747,287	0
1.	Mbështetja e Luftimit	3,352,024	3,352,024	-	298,583	298,583	-	3,650,607	3,650,607	0

2.	Arsimimi Ushtarak	468,125	468,125	-	8	8	-	468,133	468,133	0
3.	Mbështetje për Shëndetësinë	793,563	793,563	-	86,523	86,523	-	880,086	880,086	0
4.	Mbështetje për Ushtarakët	3,500,000	3,500,000	-	-	-	-	3,500,000	3,500,000	0
5.	Emergjencat Civile	406,274	406,274	-	99,939	99,939	-	506,212	506,212	0
	Totali	12,732,326	12,732,326	-	2,875,083	2,875,083	-	15,607,409	15,607,409	0

Ashtu siç vërtetohet nga tabela e mësipërme, të dhënat e paraqitura nga shtatë programet e Ministrisë për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2023 përputhen plotësisht me të dhënat e thesarit për këtë periudhë raportuese. Evidentojmë se në faktin e realizimit të buxhetit në këtë tabelë nuk është përfshirë shuma e të ardhurave jashtë buxhetore, të cilat kanë vlerën totale prej 20.675 mijë lekë, por kjo është përfshirë në të dhënat e tjera të këtij raporti dhe të rakorduara me degën e thesarit për çdo program.

3. INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për shtatë programet e Ministrisë situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë të 8-mujorit të vitit 2023, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të këtij viti, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.14

(në 000 / lekë)

Nr.	Emërtimi i programit	Buxheti fillestar 8-mujor, 2023	Buxheti me ndryshime 8-mujor, 2023	(Buxheti me ndryshime), (Buxheti fillestar)
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,603,724	1,606,291	(2,567)
2.	Forcat e Luftimit	18,260,500	17,999,632	260,868
3.	Mbështetja e Luftimit	7,659,659	7,675,113	(15,454)
4.	Arsimimi Ushtarak	1,363,420	1,365,559	(2,139)
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,608,536	1,609,590	(1,054)
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,200,000	-
7.	Emergjencat Civile	4,560,300	4,560,804	(504)
	Totali	40,256,139	40,016,989	239,150

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit 8-mujor paraqitet me ulje në vlerën 239,150 mijë lekë më pak se buxheti fillestar. Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program.

Në total për periudhën 8-mujore kemi ulje nga buxheti fillestar në vlerën **239,150** mijë lekë, konkretisht sipas artikujve të mëposhtëm:

Tabela nr. 15

në 000/lekë

NDRYSHIMET								
600	601	602	603	605	606	231B	231H	Totali
								0
-90,000	40,000	50,000	0	0	2,567	0	0	2,567
-42,000	56,400	-24,400	0	0	19,132	-270,000	0	-260,868
240,550	84,800	-307,500	0	0	-2,396	0	0	15,454
-45,500	2,500	0	0	0	45,139	0	0	2,139
0	0	0	0	0	1,054	0	0	1,054
0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	-32,700	0	32,700	504	0	0	504
								0
63,050	183,700	-314,600	0	32,700	66,000	-270,000	0	-239,150

- Memo e sekretarit të përgjithshëm nr.750/1prot., datë 6.2.2023 “Rishpërndarje fondëve buxhetore nga programi “Mbështetja e Luftimit”, te njësia e re shpenzuese “Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë”.
- Shkresë nr. 2421/ prot., datë 26.04.23 “Rishpërndarje fondesh për vitin 2023”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr.3315 prot., datë 12.6.2023 “Dërgohet miratim detajimi i fondit të veçantë të ushtarakëve të MM dhe civilëve të AISM”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr. 2946/4 prot., datë 20.6.2023 “Rialokim Fondi për vitin 2023”; shkresa e MFE nr. 9481/1prot., 31.5.2023 “Rialokim Fondi për vitin 2023”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr. 3090/2 prot., datë 20.6.2023 “Kërkesë për rishpërndarje fondesh”, për AKMC-në.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr. 3649/1 prot., datë.13.7.2023 “Rishpërndarje në artikullin 602 “Mallra e shërbime”.
- Shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr. 4025/1 prot., datë 18.7.2023 “Rialokim Fondi” në lidhje me VKM nr. 325, datë 31.5.2023 rialokim fondi”.
- Memo e sekretarit të përgjithshëm nr. 4111 prot., datë.20.7.2023 “Rishpërndarje fondi në art.602 “Mallra e shërbime”, shkresë e sekretarit të përgjithshëm nr.4827/2 prot., datë 26.9.2023 “Rishpërndarje fondi për art. 602 “Mallra e shërbime”.

Ndryshimet në buxhet në art. 231 “Shpenzime kapitale”, investime deri me datë 31.8.2023, “Për rishpërndarje të fondit buxhetor”, miratuar si më poshtë detajuar:

- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 3389/1 prot., datë 06.04.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 101/1 prot., datë 10.01.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6402/1prot., datë 07.04.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 1872/ 2 prot., datë 04.04.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4233/2 prot., datë 05.04.2023 (bashkitë) dërguar me shkresën e MM nr. 818/ 2 prot., datë 01.03.2023
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9022/1 date 12.06.2023(bashkitë), dërguar me shkresën e MM nr. 2789 prot., datë 16.05.2023.

- VKM nr.392, datë 29.06.2023, efektet në shtator, dërguar MFE nr.12140/1 prot., datë 07.07.2023.
- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14234/1 prot., datë 25.08.2023, dërguar me shkresën e MM nr. 4238/2 prot., datë 01.08.2023.

Shkresa në të cilën pasqyrohet ndryshimi i buxhetit është:

- Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2375 prot., datë 24.04.2023, “Dërgohet miratimi i fondit të veçantë shtesë për vitin 2023”, në shumën 7,120 mijë lekë.

INVESTIMET E HUAJA

Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 84/2022 “Për buxhetin 2023”, evidentohet ndryshimi (pakësimi) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj **në shumën 6,000 000 mijë lekë**” këto projekte nuk kaë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit, **të detajuar sipas programeve në mijë lekë:**

Pakësim:

- Programi “Forca e Luftimit”, pakësim në shpenzime kapitale në shumën 4,100,000 mijë lekë në projektin me kod 18AZ208 “Kapacitete të ofruara në modernizim”;
- Programi “Emergjencat Civile”, pakësim në shpenzime kapitale në shumën në shumën 1 900,000 mijë lekë në projektet “TO BE READY”, “FIRE PREP” DHE “ROSSES”.

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË KRIJUARA RISHTAZI JANAR - GUSHT 2023

Detyrimet e prapambetura të krijuar rishtazi për periudhën janar - gusht 2023 nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes janë në vlerën rreth 811,654 mijë lekë. Sipas natyrës detyrimet kategorizohen, si më poshtë:

- Detyrime për “Shpenzime personeli” janë në vlerën 151.milionë lekë, që janë detyrimet e akumuluar për pagesë kontributesh.
- Detyrime në zërin “Mallra dhe shërbime” janë në vlerën 76 milionë lekë detyrime për kontrata dhe fatura të papaguara.
- Detyrime në zërin “Vendime Gjyqësore” në vlerën 55 milionë lekë.
- Pjesën më të madhe të detyrimit janë në zërin 604 për përballimin e fatkeqësive natyrore në vlerën 529 milionë lekë, detyrime që janë krijuar nga ish-DPEC.

Gjatë periudhës janar - gusht 2023 janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 1,746,315 lekë me fondet e akorduara të këtij viti nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes. Theksojmë se këto detyrime i përkasin detyrimeve të prapambetura ndër vite. Gjatë vitit 2023, referuar realizimit të pritshëm të buxhetit, do të shihet mundësia e rialokimit të fondeve midis artikujve, me qëllim

likuidimin e detyrimeve të prapambetura, por edhe janë bërë kërkesat përkatëse në fazën II të PBA 2024-2026.

Si konkluzion, në total realizimi i buxhetit (FB+FH+TA jashtë limit) të 8-mujorit të vitit 2023 për Ministrinë e Mbrojtjes është në masën 70 % të specifikuar sipas kategorive kryesore të shpenzimeve, si më poshtë:

- a) **Shpenzimet korente janë realizuar në masën 80 %**, prej të cilave:
- **Shpenzime personeli (600-601)** në masën 92%. Realizimi është në nivelin e pritshëm me përjashtim të mangësive në struktura të personelit të paplotësuar.
 - **Shpenzime të tjera (602-606)** në masën 72 %. Siç shihet nga anekset përkatëse, mosrealizime të theksuara ka në shpenzimet për mallra e shërbime (art 602) të cilat i përkasin programeve:

“Emergjencat Civile” në shumën 140,264 mijë lekë dhe programi buxhetor “Mbështetja e Luftimit” në shumën 778,206 mijë lekë si mosrealizim të procedurave të prokurimit dhe mosrealizim të pagesave.

b) **Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 46%**

Përsa i përket shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me plan vjetor në shumën 17,617 milionë lekë dhe plan 8-mujor në shumën 6,213 milionë lekë kanë një realizim prej 2,875 milionë lekë ose në masën 46 %. Mosrealizimi i fondit ndikohet nga procedurat e prokurimit që janë në përmbyllje ose disa janë në proces, ashtu edhe në realizim faktik të ulët të atyre të kontraktuara.

c) **Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 0 %.**

Investimet me financimin e huaj, me plan vjetor në shumën 6,000 milionë lekë dhe plan 8-mujor prej 200 milionë lekë, paraqiten me nje realizim në shumën 0 milionë lekë ose në masën 0 % ndaj planit 8-mujor dhe 0 % ndaj planit vjetor.

Në vlerësimin përfundimtar konstatojmë se realizimi i buxhetit në fund të kësaj periudhe është në nivelin normal por jo të pritshëm, sidomos në zërin “Investime të brendshme” dhe mosrealizimit të shpenzimeve për “Mallra e shërbime” për të gjitha shkaqet që u sqaruan gjatë këtij raporti.

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore nëpërmjet analizave dhe nxjerrjes së përgjegjësisë për strukturat që rezultuan me mosrealizime të theksuara.

Problematikat e konstatuara gjatë këtij 8-mujori do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit, me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vijim.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gelardina Prodani